



PROCESVERBAL V/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VI (gjashtë) për vitin 2023 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 22.06.2023
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Fidaije Kukaj Përfaqësues i LMT-së
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2024-2026;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përcaktimin e vlerës së bonos banimit;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e Rregullores 01-Nr-209;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Ekonomike” në Duhël;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Industriale” në Shirokë;**
- 7. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Komunal të Aksionarëve i NPL “Stacioni i Autobusëve” në Suharekë për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe raporti i Komisionit Komunal të Aksionarëve i NPL “Stacioni i Autobusëve” në Suharekë;**

Urim Suka - në mbledhjen e fundit të KPF-së unë kam kërkuar një pikë shtesë e cila është edhe e paraparë në plan të punës së Kuvendit për raportimin e Kryetarit të Komunës mbi shpenzimin e buxhetit të Komunës për vitin 2022. Ju kërkuat që të tërhiqet si pikë sepse u zotuat që do të bisedoni me Kryetarin dhe do ta sillni në mbledhjen e radhës por kjo pikë nuk ka ardhë. Kërkoj sqarime se çka ka ndodh dhe të njëjtën kohë kërkoj që të miratohet kjo pikë për rend dite.

Kryesuesi - është e vërtetë kjo. Unë kam bisedu me Kryetarin dhe sipas procedurave që janë, Kryetari e ka obligim ti raportojë qytetarëve të Komunës së paku dy herë në vit dhe ai nuk e sheh të arsyeshme që të bëj një raport në Kuvend. Zyrtari ligjor edhe herën e kaluar ka dhënë sqarime.

Urim Suka - kjo që po e kërkoj unë është e rregulluar me udhëzim administrativ dhe gjithashtu është në plan të punës që ju vet e keni miratu dhe kërkojmë të zbatohet plani i punës.

Avni Bytyqi - sa i përket shpenzimeve Kryetari ka raportuar për vitin 2022 në janar. Është në diskrecionin e Kryetarit se a do të raportojë para qytetarëve apo para Kuvendit. Është thjeshtë informatë.

Urim Suka - unë po e kërkoj atë që e keni miratu dhe Kuvendi është zëri më i madh.

Avni Bytyqi - nuk e kemi obligative ti përmbahemi atij plani. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Urim Suka - a është obligim ligjor që Kryetari ti raportojë Kuvendit?

Avni Bytyqi - Për punën e vet jo ndërsa për çështje financiare po.

Urim Suka - unë kërkoj që kjo pikë të jetë në rend dite.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë për rend dite.

3 për,3 kundër

Kryesuesi përdor të drejtën e votës së dyfishtë dhe voton kundër.

Nuk miratohet pika shtesë

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

**3 për,2 kundër,1 abstenim
Miratohet rendi i ditës**

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2024-2026;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Dardan Berisha - i përmende dëgjimet publike dhe nuk e di sa janë marrë parasysh propozimet e qytetarëve nga ana e komisionit. Mendoj që ishin përfshirë të gjitha fshatrat dhe te ndarja proporcionale e buxhetit në disa fshatra kam pa që ndoshta mund të jenë dhe gabime.P.Sh. në Muhlan tri rrugë janë 10.000 € kurse në Greikoc pesë rrugë 107.000 € dhe kjo është shumë.Te ndërtimi i urave në Greikoc,Mushtisht dhe Skllapuzhan janë 415.000€,a ka ndonjë riparim apo çka?Te ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza në Dubravë 330.000€ kurse në Sllapuzhan 195.000€.Kërkoj sqarime.

Kryesuesi - në Dubravë lidhen dy fshatra.

Dardan Berisha - Te Drejtoria e Urbanizmit unë kam kërku në disa seanca sepse ka pakënaqësi te banorët rezident të ndërtesave për parkingje.Ndërtimi i fushave sportive në Sopijë dhe Komunë është 682.405€ dhe të njëjtën kohë është edhe te arsimi ndërtimi i sallës së sportit në Sopijë.

Kryesuesi - terenet sportive i ka Drejtoria e Kulturës kurse sallat sportive i ka Drejtoria e Arsimit.

Dardan Berisha - për një fshat edhe terenet sportive dhe sallën e sportit por në një fshat s'ka as teren e as sallë.Do të ishte mirë që Drejtorët të ishin prezentë dhe të jepnin sqarime.

Kryesuesi - qarkorja buxhetore ka ardhë me 15 maj dhe Drejtoria e Financave e ka përgatit një agjend takimi ku janë formuar 7 grupe të cilat kanë dal në teren .Janë marrë disa shqetësime,kryesisht rrugë.Kryesuesi tutje jep sqarime.

Urim Suka - për mua është e pa pranueshme se si po e përgatitni një dokument kaq serioz.Ne këto tema veq i kemi ngrit edhe vitin e kaluar dhe ju vazhdoni nën logjikën e njejtë dhe unë habitem se si Ministria në fund i miraton dhe nuk i shikon.Ne sot po diskutojmë për kornizën afatmesme buxhetore për tri vjet.Psh. në Duhël është planifiku ndërtimi i rrugës Vllezërit Qatani dhe Hivzi Sylejmani dhe në bazë të planifikimit për dy rrugë po planifikohet tri vite investim.Në Luzhnicë,rruga Afrim Buqa është e shtruar një pjesë(shumica) edhe për vitin 2023 kjo rrugë është në planifikim të buxhetit.Tash prap në këtë kornizë,rruga Afrim Buqa për tri vite është në planifikim.Shembuj të njejtë ka plot.Te ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në Biraq puna ka fillu dhe në vitin 2022 janë paguar një shumë e parave dhe punët s'kanë fillu dhe paratë kanë shku dikund tjetër me një vendim të Kryetarit.Në vitin 2023 është bërë një kontratë 170.000€ dhe kanë fillu punët kurse për vitin 2024,2025 dhe 2026 janë planifiku 1.000.050 e që kjo për mua është e pa kuptueshme duke e llogaritur që unë kam pas kërkesë për dy vite për varrezat në fshatin Bllacë ku është problem i madh.Te ndërtimi i kolektorit në rrugën Skënderbeu,400.000€ janë hargju pa ligjshëm në vitin 2022 dhe në emër të saj kanë shku dikund tjetër,për vitin 2023 janë të planifikuara afër 300.000€ dhe për vitin që vjen janë planifiku vetëm 50.000€,në vitin 2025 janë 350.000€ dhe në vitin 2026 janë 400.000€ dhe për mua është e çuditshme dhe e pa kuptueshme.Te objekti i Komunës a i keni planifiku 10.000 apo 100.000€?As me 10.000 dhe as me 100.000 nuk mund ta bëni objektin e Komunës.Kët vit i keni 50.000 dhe vitin e ardhshëm i keni planifiku 100.000 kurse në vitin 2025 dhe 2026 nuk keni planifiku fare.Çka ka me ndodh me këto para?Blerja e paisjeve dhe aparaturat e nevojshme për QKMF Suharekë 600.000€,unë mendoj që janë shumë duke e llogaritur vitin e kaluar që sa mjete janë dhënë për paisje.Mos prezenca e Drejtorëve është e pa përgjegjshme.Unë jam kundër kësaj kornize buxhetore.

Liridon Fandaj - vitin e kaluar pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë shumë më e madhe në dëgjime publike se sa këtë vit.Ka pas shumë më shumë propozime mirëpo kërkesat e qytetarëve nuk janë përfill dhe për këtë arsye pjesëmarrja është shumë më e vogël këtë vit.Në Peqan janë ndarë 30.000€ dhe asnjë prej propozimeve të qytetarëve nuk janë përfshi.Rruga "Lulëkuqja" është tenderu një herë dhe është shtrur diçka tjetër.Prapë është në planifikim rruga Lulëkuqja dhe Amerika dhe asnjëra prej tyre nuk janë propozime të qytetarëve.Në dëgjime publike,në panel e kam pa edhe zëdhënës drejtorin e QKMF-së.A mund të jetë kush do në panel për prezantimin e KAB?410.000€ te ndërtimi i zonës infrastrukturore smart,kërkoj sqarime se çfarë projekti është.Për ndërtimin e aneksit të objektit sh.m.u"Besim Ndreca" në Maqitevë janë dhënë 200.000€ dhe në 2023 janë 120.000 €.A ka fillu ky aneks të ndërtohet?Vitin e kaluar në Maqitevë,shqetësimi i drejtorit ka qenë që do të mbyllet shkolla sepse ka pak nxënës.Janë disa ndryshime te paga dhe meditje dhe besoj që është ndryshimi i ligjit në paga por dua sqarime se a është

ndryshimi në paga apo rritet stafi?Për projektet kapitale unë jam kundër dhe vota në Asamble ka me qenë kundër.

Fadil Hoxha - Qarkorja buxhetore ka ardhë me 15 maj dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka fillu planifikimin si fazë fillestare.Buxheti është për 11.5% më i madh se sa në vitin aktual.Pjesa më e madhe është te paga dhe meditje 2.292.000 kurse të gjitha të tjerat kanë pësuar rënie krahasuar me vitin aktual.

Subvencionet janë 25.000 më shumë ndërsa projektet kapitale janë 41.000 më pak se në vitin aktual.Arsyeja se pse pagat janë në total më shumë,është sepse ka ndryshu ligji i ri i buxhetit në paga.Korniza afatmesme buxhetore vje çdo vit dhe çdo vit bëhen projektet kapitale.Këtë vit bëhen për 2024-2025-2026,vitin tjetër bëhet për 2025-2026-2027.Pra,projektet e viti 2025-2026 nuk do të thotë që mbesin ashtu,mund të ndryshohen.Ndërsa qarkorja e dytë i definon saktë të gjitha kategoritë.ZKF tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - kritika ime është sepse kërkesat e qytetarëve nuk po implementohen.Nëse e ke vendos me një KAB të vitit të kaluar rrugën Lulëkuqja,ose u dasht me qenë segment ose mos me qenë,sepse ajo ka dalë një herë në tender dhe nuk është shtru.

Kryesuesi - gjatë implementimit të projekteve në rrugë,nga një herë ka bllokim.Ne kemi problem me rrugën Xhelal Kuçi, ku insistohet të rregullohet por ka problem me prona aty.

Liridon Fandaj - te pozicioni rrugë në Komunë,a mund të vendoset aty por pa emër,sepse në Peqan rruga Emërllah Hoxha ka dal 4-5 herë.

Urim Suka - unë po flas në bazë të dokumentit që ju keni sjell dhe po e kritikoj dokumentin me fakte konkrete.Unë dua të kontribuoj që ky dokument të jetë më i mirë.Kur të vjen qarkorja e dytë unë e jap mendimin për qarkoren e dytë por unë sot po flas për këtë që e keni sjell sot.Për këtë dokument ju i keni dërgu shkresë Kryetarëve të fshatrave për ti caktuar prioritet.Disa prej tyre që unë kam pas kontakt,nuk janë pasqyru njejtë siç i kanë sjell ata.Unë kam dëshirë,nëse është e mundshme ta bëj një krahasim dikush prej Drejtorisë së shërbimeve Publike se çfarë propozimesh kanë sjellë Kryesitë e fshatrave dhe cilat prej propozimeve janë inkorporu dhe cilat jo,gjithëashtu edhe arsyet se pse nuk janë inkorporu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2

3 për, 3 kundër

Kryesuesi e përdor të drejtën e votës së dyfishtë dhe voton për.

Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përcaktimin e vlerës së bonos banimit;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - a jemi me vonesë sa i përket këtij projekt-vendimi kur dihet se gjysma e vitit vetëm ka kaluar? A ka raport për këto familje aktuale të cilat i kemi miratu vitet e kaluara?

Kryesuesi - edhe unë kam kërku një raport nga Drejtoresha se cilat familje janë përfituese mirëpo sipas drejtoreshës ka raste edhe kur tërhiqen.Kryesuesi tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - nëse dikush tërhiqet është mirë të zëvendësohet me dikënd tjetër.A është mundësia?

Avni Bytyqi - po, është mundësia dhe e aplikon drejtoria e shëndetësisë. Ligji e obligon secilin që nëse krijon kushte të mira dhe nuk ka nevojë që ta subvencionojë Komuna, është i obliguar të raportojë.

Liridon Fandaj - unë mendoj që është edhe çështja e informimit është shumë e rëndësishme.

Avni Bytyqi - thirrja bëhet publike.

Urim Suka - për deri sa ne e kemi marrë një vendim,unë kërkoj një raport detal se sa familje e kanë gëzu këtë të drejtë vitin që shkoi dhe sa para janë hargju.Nëse ka kërkesa dhe është e nevojshme,a ka mundësi Komuna me rrit numrin e familjeve përfituese?

Avni Bytyqi - Ai që aplikon dhe përfituesi e ka për obligim ta sjell kontratën që e ka lidh. Zyryari ligjor tutje jep sqarime.

Liridon Fandaj - ky komision a e ka për obligim ta bëjë edhe monitorimin ?

Avni Bytyqi - po.

Dardan Berisha - edhe unë kërkoj një raport.A mundemi ne me pas qasje si Asamble sepse nuk e di kush është në komision?

Avni Bytyqi - sipas udhëzimit administrativ ekskluzivisht është kompetencë e kryetarit të Komunës dhe nëse Kryetari i Komunës do ta delegojë te Kuvendi, kjo është në kompetencë të tij.

Dardan Berisha - nëse as 60 % nuk e paguan?

Avni Bytyqi - ne i paguajmë obligimet tona dhe ata merren vesh mes vete.

Urim Suka - nëse kanë konkuru 7 familje dhe dy tërhiqen, atë fond hargjone dhe këtë 40 % rriteni nëse ka mundësi.

Avni Bytyqi - nuk e lejon ligji, maksimumi është 50%.

Dardan Berisha - është mirë të bëhet 50 %.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e Rregullores 01-Nr-209;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - në seancën e kaluar, faljen e borgjeve ne u detyruam mos ta votojmë sepse nuk e keni sjell raportin dhe pata kërkuar që, ose ti ulni tarifat e kësaj rregullore nëse janë të pa përballueshme për sportet ose të bëhen zero dhe të shfuqizohet rregullorja. Tash ka ardhë të shfuqizohet rregullorja dhe unë kam një shqetësim që mendoj që duhet të trajtohet për të ardhmen. Unë mendoj që palestra një rregullore në fuqi duhet ta ketë por ne duhet tarifat ti bëjmë zero dhe nuk duhet ta shfuqizojmë krejt si rregullore sepse ajo rregullore parasheh edhe gjëra tjera. Mendoj që duhet të bëhet plotësim-ndryshim i rregullores.

Dardan Berisha - edhe unë pothuaj pikë për pikë i pata ato që tha Urimi. Nëse ne sot e shfuqizojmë rregulloren, me çfarë rregullore ne duhet të funksionojmë tash? Kur do të hyjë në fuqi rregullorja e re?

Bulëza Kuçi - unë mendoj që duhet të miratohet dhe të shfuqizohet rregullorja tjetër mirëpo kur parashtrohet kërkesa për një rregullore tjetër atëherë minimum 30 % duhet me qenë nevoja e ndryshimit të rregullores. A është e nevojshme 30 % të ndryshohet kjo për të vazhduar me tjetrën?

Liridon Fandaj - unë kisha thënë që të bëhet rregullorja tjetër dhe në moment që s'është rregullorja e shfuqizojmë tjetrën ose nëse duam ta heqim pjesën e pagesës, me një vendim ta shfuqizojmë atë nen.

Urim Suka - kur kemi dasht me i shly borgjet, atë ditë është dasht me ardhë plotësim-ndryshimi për rregullore.

Liridon Fandaj - nëse ne e shfuqizojmë këtë rregullore, a ka implikime buxhetore në Drejtorinë e kulturës?

Kryesuesi - nuk ka implikime buxhetore.

Avni Bytyqi - rregullorja është e 2005-tës. 2015-tën është rregullorja për tarif ngarkesa e cila është e përgjithshme e të gjitha drejtorive. Në kuadër të kësaj rregullore janë të përfshira të gjitha tarifat që janë të parapara për këtë rregullore mirëpo deri më tani zyrtari i palestrës sportive dhe auditorët e brendshëm dhe të jashtëm iu kanë referu kësaj rregullore. Ne rregulloren e 2015-tës nuk e kemi shfuqizuar dhe ne aktualisht jemi duke e shfuqizuar këtë rregullore. Është aktualisht rregullore për tarif ngarkesa që po aplikohet shumë shpejtë të bëhet rregullore e re dhe në kuadër të saj, ne me drejtoreshën kemi menduar të ul tarifat dhe ju jeni ata të cilët vendosni.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

**3 për, 3 abstenime
Miratohet pika 4**

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Ekonomike” në Duhël;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime se pse janë kthyer vendimet.

Liridon Fandaj - a ka ndonjë ministri të linjës që duhet të aprovojë këto zona? Nëse dy ose tri herë na i kthen e njëjta ministri, a ka mundësi si qeveri me iu drejtu të njëjtës ministri? Prap duhet ta bëjmë një vendim tjetër që ndoshta na refuzon ministria e Infrastrukturës.

Avni Bytyqi - ne i kemi të licencuara. Për të licencuar një zonë duhen një varg dokumentash. Është udhëzimi administrativ i ministrit të tregtisë së 2014-tës kur ne i kemi licencuar dy zona: Agro Zonën në Samadraxhë dhe Zonën Industriale në Shirokë. Tani me ligjin e ri e parasheh që ta ketë planin rregullues të

hollësishëm. Ne paraprakisht jemi duke e bërë planin rregullues të hollësishëm dhe tani ti plotësojmë dokumentet tjera për të dërguar kërkesën në Ministri të Tregëtisë për tu licencuar Zona Ekonomike në Duhël.

Urim Suka - është hera e tretë që vje! E kemi votu edhe atëherë për inicim dhe do ta votojmë prap.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për inicimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Industriale” në Shirokë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin. Pasi nuk ka debat Kryesuesi e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet pika 6.

Pika 7. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Komunal të Aksionarëve i NPL “Stacioni i Autobusave” në Suharekë për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe raporti i Komisionit Komunal të Aksionarëve i NPL “Stacioni i Autobusave” në Suharekë;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - këto parregullësi i përmende edhe vet, i kam has edhe unë mirëpo mua më shqetëson një fajali këtu ku thuhet: ne si Komision Komunal i Aksionarëve ndihemi të shantazhuar dhe kemi presion psikologjik.

Kryesuesi - faktikisht ne mund ta diskutojmë edhe në Asamble pasi ata nuk janë të pranishëm.

Liridon Fandaj - nëse dikush është i shantazhuar atëherë duhet të merren organet.

Kryesuesi - unë si Kryesues e kam obligim ligjor ta kërkoj një raport në bazë të fjalëve që kam dëgjuar. Ata e kanë përgatit raportin të cilin ia kam përcjell edhe juve, që ju të jeni në dijeni se çka po ndodh.

Urim Suka - fjalja në fund e ngrit alarmin për ta marrë seriozisht secili prej nesh dhe secili organ që është përgjegjës për këtë punë.

Kryesuesi - unë kërkoj nga ju që ta dërgojmë në Asamble dhe ta formojmë komisionin.

Urim Suka - raporti që kanë dorëzuar paraqet një kronologji të zhvillimeve që ka ndodh dhe po kërkon nga ne si Asamble të formojmë një komision për shqyrtimin e ankesave. A duhet ne ta formojmë një komisin apo jo dhe a kemi bazë ligjore dhe si ka me funksionu?

Kryesuesi - arsyeja se pse kanë kërku është sepse janë dy ankesa të kandidatëve që kanë aplikuar dhe kanë qenë të pakënaqur edhe pse kërkesa për formimin e komisionit është me vonesë.

Liridon Fandaj - nëse e shpall një konkurs duhet me qenë edhe komisioni i ankesave dhe tash kanë përfunduar të gjitha procedurat.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që ne jemi të detyruar ta zbatojmë ligjin dhe e kemi obligim ligjor ta formojmë komisionin.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

3 për, 3 apstenime
Miratohet pika 7.

Takimi përfundoi: 14:40

Procesmbajtësja
Dafina haziraj